



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.07.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatjona Dhimitri – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me rektorë të universiteteve publike për diskutimin e projektligjit “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë” (*komision përgjegjës*).

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Almira Xhembulla, Vilma Bello, Lindita Nikolla, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Mirela Kumbaro, Klajdi Qama, Kostaq Papa, Selami Jenishehri.

Mungojnë:

Enada Kapllani

Deputetë të grupit propozues:

Senida Mesi, Mimi Kodheli dhe Elona Gjebrea.

Të ftuar:

Agron Cuko – rektor i Universitetit të Sportit, Tiranë,

Lek Sokoli – zëvendësrektor i Universitetit “Aleksandër Mojsiu”, Durrës,

Adem Bekteshi – rektor i Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër,

Skënder Topi – rektor i Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan,

Sulejman Sulçe – zëvendësrektor i Universitetit Bujqësor, Tiranë,

Valbona Duri – zëvendësrektore e Universitetit “Eqerem Çabej”, Gjirokastër,

Sokol Banaj – zëvendësrektor i Universitetit “Ismael Qemali”, Vlorë,

Redi Shtino – zëvendësministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

HAPET MBLEDHJA

Fatjona Dhimitri - Mirë se erdhët në mbledhjen e radhës së komisionit!

Sot në rendin e ditës kemi seancën dëgjimore për shqyrtimin e projektligjit “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, propozim i një grupi deputetësh.

Të ftuar kemi rektorë dhe zëvendësrektorë të universiteteve publike: zotin Agron Cuko, rektor i Universitetit të Sporteve, Tiranë; zotin Lekë Sokoli, zëvendësrektor i Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës; zotin Adem Bektashi, rektor i Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër; zotin Skënder Topi, rektor i Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan; zotin Sulejman Sulçe, zëvendësrektor i Universitetit Bujqësor, Tiranë; zonjën Valbona Duri, zëvendësrektore e Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër; zotin Sokol Banaj, zëvendësrektor i Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë; nga MASR, zotin Redi Shtino, zëvendësministër.

Të nderuar profesorë, së pari, ju shpreh mirëseardhjen!

Ju lutem, të shprehni mendimet tuaja lidhur me propozimin e grupit të nismëtarëve për projektligjin “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”.

Fjalën e ka zoti Agron Cuko.

Agron Cuko - Faleminderit!

Ju falënderojmë që na ftuat të marrim pjesë në këtë komision për të diskutuar diçka mjaft të rëndësishme për sistemin tonë akademik, siç është Akademia e Shkencave, që kohët e fundit ka kaluar disa problematika. Që kur na erdhën dy draftet e punuara nga dy profesorë të nderuar, unë i lexova me shumë kujdes. Sot këto dy materiale janë përmbledhur në një material të studjuar dhe të përgatitur, kështu që unë shpreh miratimin tim që në fillim.

Do të ndalem në dy momente që mua më duken positive: së pari, hapja më e gjerë e Akademisë duke na dhënë mundësinë edhe ne të sporteve të përfshihemi dhe të kemi akademikët tanë, që mund të jenë anëtarë të kësaj akademie, por edhe për çdo staf akademik që të marrë pjesë në Akademinë e Shkencave.

Diçka tjetër pozitive që shoh në këtë material është ngritja e Akademisë së të Rinjve, e cila do të jetë një mundësi më e madhe për të rinjtë tanë, shkencëtarët tanë të rinj, që deri në një moshë të caktuar, 42 vjeç, të nxiten për të përparuar më tej dhe për të qenë anëtarë të Akademisë së Shkencave.

Fatjona Dhimitri – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Adem Bekteshi.

Adem Bekteshi – Ju falënderoj për ftesën!

Ne jemi konsultuar me profesor Skënderin dhe kemi një material të shkruar, që do ta depozitojmë.

Ky projektligj është një tendencë hapjeje e Akademisë. Duke qenë rektor universiteti, unë shoh se bashkëpunimet nuk janë në nivel të barabartë me universitetin. Të mos harrojmë se në ligjin e arsimit të lartë departamenti ka rolin kryesor në kërkimin shkencor, përveç instituteve. Në këtë projektligj Akademisë i është lënë roli udhëheqës i gjithë kërkimit shkencor, por unë mendoj se edhe universitetet kanë një rol të rëndësishëm.

Përveç kësaj, planet e punës shkencore, programet e përgatitjes së kuadrove, kualifikimeve shkencore në gradat asistent profesor, profesor, qoftë edhe doktor, ne nuk mund t'ia delegojmë Akademisë. Universitetet duhet të jenë qendra të kërkimit, si edhe Akademia. Akademia me të vërtetë është institucioni më i lartë, por të mos harrojmë se edhe universitet luajnë një rol të rëndësishëm, sepse janë universitete që përgatisin akademikët e ardhshëm. Universitetet kanë përparësinë, sepse kanë të rinjtë që i fusin në kërkimin shkencor.

Gjithashtu, ka edhe një pikë tjetër që mua nuk më duket e barabartë, Akademikët nuk kanë kundërshtim të marrin pjesë në senatet e universiteteve, por cili është roli i tyre në këto senate? Nëse e shkruajmë në këtë formë që akademikët duhet të jenë anëtarë të senateve, në fakt, kur ligji thotë që anëtarët e senateve zgjidhen të gjithë me votë nga trupa, këto janë *ex office*, si rektori. Atëherë, pse nuk barazohet universiteti me Akademinë që edhe rektorët të mund të jenë jo pjesë integrale, por pjesë e ftuar e Asamblesë në Akademi?

Pra, në rastin e kërkimit shkencor, Akademinë e kemi lejuar të futet në universitet në një pjesë të madhe, kurse universiteti, në fakt, në këtë ligj nuk e gjen veten, e gjen veten vetëm si prodhimtar të akademikëve të ardhshëm, por jo në hartimin e planeve kërkimore-shkencore, jo pjesëmarrës në hartimin e të gjitha niveleve të përgatitjes së gradave dhe titujve shkencorë që jepen. Nëse ne në nivelin e tretë përgatisim kryesisht doktorantët dhe nëse këtë nivel duhet ta udhëheqë Akademia, cili do të ishte roli i universitetit në kërkimin shkencor?

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Fjala për zotin Skënder Topi.

Skënder Topi – Faleminderit!

Mbështes parafolësit, profesorët Çuko dhe Bekteshi. Unë do të jem më konkret. Ju kemi përgatitur edhe me shkrim reflektimet tona për këtë projektligj.

Së pari, një falënderim të veçantë për grupin e punës, që me të gjithë problematikat që ka pasur Akademia e Shkencave, kanë arritur të sjellin këtë projektligj.

IAL-të kanë qenë pjesë jashtë sistemit, kurse sot po diskutojmë një projektligj që kërkon të bëjë një gjë të mirë, që Akademia e Shkencave të funksionojë dhe t'i shërbejë jo vetëm vendit, por edhe ballafaqimit në arenën ndërkombëtare.

Sa i përket projektligjit, unë mendoj se, së pari, ka një mospërputhje mes qëllimit të këtij projektligj, rolit dhe funksioneve të tij. Sipas draftit qëllimi i ligjit është përcaktimi i kuadrit ligjor për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Shkencave dhe, nga ana tjetër, jep attribute për krijimin e njësive të veçanta të kërkimit shkencor, të cilat organizohen dhe veprojnë në bazë të një ligji specifik, që është ligji i arsimit të lartë, i cili është debatuar gjatë në ambientet tona universitare, por sot duhet të themi që ligji i arsimit të lartë ka të gjitha aktet nënligjore, pra është në funksion e sipër.

Së dyti, në lidhje me monitorimin e procesit kërkimor, që kërkohet të realizohet nga Akademia e Shkencave, ky monitorim është në shkelje të ligjit të arsimit të lartë, pasi ky i fundit bashkë me aktet nënligjore të dala në emër e për llogari të tij, rregullon të gjithë procesin akademik të kërkimit shkencor, është pjesë e lirisë akademike dhe autonomisë të arsimit të lartë, ku thuhet: “Për të organizuar mësimdhënien, veprimtarinë kërkimore-shkencore, inovacionin dhe veprimtarinë krijuese për të hartuar dhe zhvilluar programe studimi dhe për të përcaktuar fushën e veprimtarisë kërkimore - shkencore”. Pra, është pjesë e arsimit të lartë, është pjesë e universitetit dhe njësive bazë të departamenteve. Gjithashtu, nëpërmjet këtij ligji është krijuar një sistem i unifikuar i arsimit të lartë, kërkimit shkencor në institucionet e arsimit të lartë, inovacionit bashkëkohor dhe konkurrues në hapësirën europiane të arsimit të lartë, duke kërkuar nga shteti, organet e tij, strukturat përgjegjëse garantimin e autonomisë dhe lirisë akademike.

Së treti, në lidhje me detyrat dhe të drejtat e anëtarit të asamblesë, keni përcaktuar në mënyrë taksative, në pikat 6 dhe 8, që anëtari të kërkojë dhe të marrë informacion për punën shkencore, planet dhe programet e përgatitura nga institucionet e arsimit të lartë, nga institucionet kërkimore për fushën që mbulojnë, të marrë pjesë në senatet akademike dhe komisionet e përhershme të institucioneve publike të arsimit të lartë ose në institucionet ku ushtrojnë veprimtarinë tyre, ose e kanë ushtruar për një kohë të gjatë një prej tyre si anëtar *ex office*, të marrë

pjesë në njësitë ose grupet e punës për studimin, hartimin dhe kërkimin në fusha të caktuara. Kërkimi dhe marrja e informacionit për punën kërkimore - shkencore nuk është qëllimi i veprimtarisë së këtij ligji dhe për këtë arsye Akademia duhet të kërkojë të bashkëpunojë e të koordinojë me IAL-të në lidhje me punën kërkimore - shkencore ose strategjitë e tyre në lidhje me kërkimin shkencor. Senati akademik i IAL-ve është organi kolegjal më i lartë akademik i institucioneve të arsimit të lartë, përgjegjës për përmbushjen e misionit të tij. Ligji i arsimit të lartë ka përcaktuar përbërjen e tij: “Anëtarët e senatit akademik të institucioneve të arsimit të lartë zgjidhen nga asambltetë dhe personeli akademik i njësive kryesore, përmes një votimi të përgjithshëm për një mandat 4-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje midis anëtarëve të personelit akademik me kohë të plotë, të vetëkandiduar”. Në ligjin e arsimit të lartë dhe në aktet e brendshme të IAL-ve nuk janë parashikuar anëtarë *ex office*, të cilët nuk kalojnë në votim.

Kështu që, sipas mendimit tonë ky projektligj që keni propozuar nuk prevalon mbi ligjin që rregullon veprimtarinë e IAL-ve.

Të nderuar anëtarë të komisionit, jam absolutisht pro miratimit të një ligji dhe kuadrit të mirëfilltë ligjor, i cili do të risjellë funksionimin e plotë të Akademisë së Shkencave, por kurrësi nuk mund të jem dakord me cenimin autonomisë universitare dhe ndërhyrjen në organet e rëndësishme qeverisëse akademike.

Pra, në dy nene të ligjit thuhet se Akademia e Shkencave monitoron kërkimin shkencor në universitete, por kjo bie në kundërshtim të hapur me ligjin e arsimit të lartë, dhe që anëtarët e Akademisë të jenë pjesë e senateve akademike, por edhe kjo bie ndesh me ligjin për arsimin e lartë.

Unë mendoj se që Akademia e Shkencave të funksionojë sa më mire, ne rektorët ose anëtarët e senateve duhet të jemi pjesë e Akademisë së Shkencave. Pra, Akademia duhet të krijojë bazat ligjore që të ketë një bashkëpunim zyrtar me IAL-të.

Fatjona Dhimitri - Faleminderit!

Fjala për zotin Sulejman Sulçe.

Sulejman Sulçe – Faleminderit për ftesën në këtë dëgjese për projektligjin “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”.

Edhe sipas mendimit tim projektligji përfaqëson dy amendime që janë miksuar shumë mirë dhe që në përgjithësi Akademia e Shkencave merr një rol të ri dhe bëhet edhe më e hapur.

Pra, ne jemi dakord me projektligjin, por kemi edhe disa sugjerime.

Që në fillim në definicionin për Akademinë duket që Akademia merr përsipër kërkimin shkencor, sepse prevalon mbi universitetin ose mbi institucionet e arsimit të lartë, duke thënë që në fjalinë e parë që përfaqëson dhe mban vlerat më të mira të kërkimit shkencor. Nuk jam i sigurt nëse ky rol i takon Akademisë së Shkencave. Ka një elitë të përcaktuar, e cila më së shumti zhvillon debatin dhe rregullon bashkëveprimin për kërkime të veçanta ose specifike, por nuk besoj se e merr këtë rol në mënyrë totale, sepse pastaj biem në kundërshtim me ligjin e arsimit të lartë, i cili e paracakton shumë qartë dhe, për më tepër, po të mendojmë se çfarë peshe zë Akademia në komunitetin shkencor nuk mendojmë se merr përsipër të bëjë dhe të përfaqësojë tërësisht kërkimin shkencor. Projektligji është munduar që të përcaktojë se çfarë merr përsipër Akademia.

Po të shikojmë në faqen 2, në pikën 6 të nenit 5 thuhet: “Të nxisë dhe të udhëheqë krijimin e njësive të veçanta të kërkimit”, dhe në pikën 7: “të votojë organe periodike dhe vlera të tjera me nivel të lartë ndikimi shkencor”. Përcaktimi është shumë i dobët. Deri tani Akademia e Shkencave, si dhe universitet shqiptarë kanë bërë periodikë, kanë botuar, por asnjë nga periodikët shqiptar deri sot nuk është në indeksin SCOPUS. Mendoj se kjo duhet marrë shumë në konsideratë. Akademisë duhet t’i përcaktohet niveli i kërkimit shkencor “me nivel të lartë në plan ndërkombëtar”. Pra, që ne të synojmë për t’u indeksuar në revista që na i kërkon ligji i arsimit të lartë.

Në pikën 13 thuhet: “të monitorojë procesin e kërkimit që realizohet në rrjetin e institucioneve publike”. Më duket se kjo është një kafshatë shumë e madhe për Akademinë, sepse nuk e monitoron dot. IAL-të i kanë mekanizmat kontrollues dhe vetëkontrollues, ndërkohë ministria është përgjegjëse në planin administrativ dhe ka agjenci të tjera që merren me kërkimin shkencor dhe monitorimin, të cilat janë të nivelit kombëtar. Kompetencat e tyre nuk mund të shkojnë tek Akademia, qoftë edhe për efekt të kapaciteteve humane që ka Akademia e Shkencave.

Unë jam dakord me pikat 6, 7, 8 të nenit 9, por duhet të tria të shikohen, për t’i dhënë vendin e duhur Akademisë në arsimin e lartë.

Gjithashtu, pjesëmarrja në senate duhet të rregullohet me marrëveshje bilaterale midis Akademisë dhe universiteteve, sepse universitetet janë po aq autonome sa Akademia.

Sa i përket moshës së pjesëmarrjes në Akademinë e të Rinjve që në projektligj është 42-vjeç, unë mendoj mos është për njerëz konkretë dhe kësaj duhet t’i ruhej, megjithatë duhet deri në 40 vjeç, pasi ka mbaruar marrja e të gjithë titujve.

Unë e kam edhe një merak e do ta them edhe në emër të kolegëve të mi të universitetit. Në përgjithësi i referoheni *All European Academies All* që me sa dimë ne, shumica e tyre janë në rolin e shoqatave dhe organizatave, nuk janë të financuara nga buxheti i shtetit. Ndërkohë, unë di raste që në vendet lindore ka disa akademi, të cilat kanë një rrjet të gjerë të institucioneve shkencore, sikurse ka pasur edhe akademia jonë. Tashmë pothuajse Akademia në Shqipëri i ka të përjashtuara të tëra institutet kërkimore dhe ia ka atashuar ato universiteteve. Në këtë rast na duhen shembuj për efektivitetin e përdorimit të parave publike; nëse është OJF, shoqatë, bashkësi, jemi plotësisht dakord, por duhen shembuj konkretë të funksionimit dhe efektivitetit të parave publike.

Ne jemi dakord që projektligji të kalojë, por duke pasur parasysh edhe sugjerimet tona.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri - Faleminderit!

Fjala për zonjën Valbona Duri.

Valbona Duri – Faleminderit!

Unë jap konsideratën time personale dhe institucionale për organizimin e këtij diskutimi në lidhje me projektligjin “Për Akademinë e Shkencave”, i cili është institucioni publik më i lartë që mbart dhe shpreh vlerat e shkencës, debatit, kërkimit shkencor, rolin që luan në thellimin e reformave në lidhje me kërkimin shkencor. Duke pasur parasysh këtë, paraqitej mjaft i domosdoshëm reformimi i Akademisë.

Në fillim do të ndalem në përparësitë e projektligjit dhe, më pas, do të jap mendimin tim në lidhje me diçka që ka nevojë për t’u rishikuar.

Ky projektligj, sigurisht, synon të ridimensionojë dhe të ripërcaktojë funksionet e Akademisë së Shkencave, duke reflektuar standardet dhe modelet më të mira europiane; synon të ripërtërijë Akademinë, duke vendosur kritere rigoroze dhe më të matshme në lidhje me pranimin e anëtarëve të rinj, ku duhet evidentuar ndryshimi i karakterit moshë, që krijon hapësira për rifreskimin e Akademisë, duke mosprëfshirë më kategorinë e akademikut të përjetshëm.

Një risi e projektligjit është krijimi i Akademisë së të Rinjve, si një organ këshillues dhe bashkëpunues pranë Akademisë, me qëllim që të inkurajojë, të nxisë dhe promovojë kërkimin shkencor të studiuesve të rinj dhe është konceptuar si fazë pararendëse për hyrjen e tyre në Akademi. Nëpërmjet këtij projektligji, në kreun e gjashtë synohet që Akademia të jetë një institucion i hapur drejt IAL-ve dhe qendrave kërkimore.

Ajo që vërehet, që u prek edhe nga parafolësit, është se ky bashkëpunim nuk do të arrijë një bashkëpunim me IAL-të, por prek lirinë akademike të universiteteve. Ne e dimë rolin që kanë universitetet, duke nisur që nga njësitet bazë, departamentet, që çdo vit hartojnë një plan pune të kërkimit shkencor e duke u ngritur në përfitimin e gradave ose titujve.

Pra, që Akademia të jetë një institucion vërtet i hapur sikurse synohet, duhet që të shikohen pjesë të veçanta të këtij projektligji, që ky bashkëpunim të jetë sa më funksional.

Së fundi, të gjithë besojmë që ndryshimet e duhura dhe sugjerimet tona të gjejnë vend në këtë projektligj.

Fatjona Dhimitri- Faleminderit!

Fjala për zotin Lek Sokoli.

Lek Sokoli - Faleminderit për ftesën!

Megjithëse personalisht do të isha më i lumtur po të mos isha ftuar. Arsyeja lidhet më shumë me një qëndrim që ne kemi kundër këtij projektligji që është paraqitur. Kur nuk të pyesin, nuk je i detyruar të japësh shpjegime, por kur të pyesin, ndërgjegjja jonë profesionale bën aq presion, sa themi ato që mendojmë nga përvojat personale.

Kisha përgatitur disa pyetje për diskutim: e para, pse duhet të ketë një ligj të ri për Akademinë e Shkencave dhe cilat janë risitë në raport me ligjin ekzistues? Në relacionin shoqërues nuk shprehet qartë se çfarë risish ka në draftin që propozojmë dhe çfarë garancish ka që ky ligj dhe kjo reformë, se po flitet edhe për të, të mos pësojë fatin e ligjeve të mëparshme të viteve 1994, 1998, 2004, 2006, 2007, 2008, 2010 me reformat shoqëruese, duke përfshirë edhe ndërhyrjet e Gjykatës Kushtetuese.

Jemi para një fakti dhe, meqenëse jam në një komision të dominuar nga socialistët, po citoj Dritëro Agollin, i cili në merakun e fundit të tij thotë: “Në të gjitha vendet akademitë po fuqizohen. Edhe në Serbi, edhe në Maqedoni, edhe në Malin e Zi. Vetëm në Shqipëri Akademia po dobësohet”.

Efektet dhe pritshmëritë, mendoj se duhet të kishte tregues të matshëm se çfarë pritshmëri janë për një akademi ndryshe. Në relacionin shoqërues të projektligjit thuhet shprehimisht: “Përpjekja për të ndërtuar një Akademi Shkencash sipas modeleve më të suksesshme bashkëkohore”. Kjo gjë, personalisht, më rezulton një e pavërtetë e madhe.

Mendoj se ky projektligj nuk i shkon problemit në thelbin e vet. Duhet pranuar se, para së gjithash, gjendja e sotme e Akademisë së Shkencave dhe e shkencës është produkt i asaj që po

e quaj “reforma rrënuese e vitit 2007”, bazuar në një ligj të vitit 2006. Në atë kohë e kemi kundërshtuar në mënyrë masive, flas në pozitën e drejtuesit të Institutit Shqiptar të Sociologjisë. Ajo e shndërroi Akademinë në një institucion honorifik. Pasojat i dimë.

Midis reformës së vitit 2007 dhe kësaj që pretendojmë të realizojmë në vitin 2019, është edhe ligji “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë”, që gjithsesi e komplikon problemin e qartësisë lidhur me kërkimin dhe rrjetin e kërkimit shkencor.

Mendoj se kjo qasje ndaj shkencës dhe kërkimit shkencor e ka bërë shumë të vështirë, madje të pamundur financimin e kërkimit shkencor në Shqipëri. Të dhënat flasin vetë. Në qoftë se marrim zërin përkatës “*Research & Development*”, Shqipëria është ndër vendet e fundit në botë për financimin e kërkimit shkencor.

Maqedonia financon për kërkimin shkencor 12 herë më shumë se Shqipëria në raport me GDP-në, Serbia 30 herë më shumë, mesatarja e BE-së është 70-fishi i financimit të kërkimit shkencor që bëhet në Republikën e Shqipërisë, kjo sipas të dhënave zyrtare.

Në relacionin shoqëruar të projektligjit nuk ka efektet buxhetore dhe nuk ndryshon gjë në raport me gjendjen ekzistuese, dakord, por ama, Akademia e Shkencave thith afërsisht 1/4 e buxhetit për kërkimin shkencor vjetor të të gjitha institucioneve të Republikës së Shqipërisë. Pra, mendoni që një Akademi Shkencash që nuk merret zyrtarisht me kërkimin shkencor, që nuk ka detyrimin ligjor për t’u marrë me të, merr 1/4 e fondit të kërkimit shkencor të Republikës së Shqipërisë!

Nuk po zgjatem, kam 15 pika që do t’jua lë me shkrim, do t’jua dërgoj edhe me *e-mail*.

Mendoj se referenca ndaj përvojës botërore është e gabuar. Ne duhet ta lëmë Gjermaninë në shkëlqimin e vetë sa i takon kërkimit shkencor, ta lëmë edhe Korenë e Jugut që investon 6% të GDP-së vetëm për kërkimin shkencor. Duhet të merremi me përvojën e vendeve më modeste, e them këtë, pasi kam qenë në shumicën dërrmuese të këtyre 45 akademive të ndryshme të botës, qoftë si drejtues i Institutit Shqiptar të Sociologjisë apo i Shoqatës Sociologjike Shqiptare, duke filluar nga Kanadaja dhe Shtetet e Bashkuara deri në Tajvan, Japoni e të tjerë.

Këtu kam nxjerrë të gjitha akademitë e Shkencës, në asnjë vend të vogël nën 5 milionë, në asnjë vend të Ballkanit, Europës Qendrore dhe Lindore duke përfshirë Austrinë, Akademia e Vjenës është akademia mëmë në botën e sotme, atje kanë dalë përvojat e akademive, në të gjitha vendet Baltike apo vendet Skandinave dhe vendet e Ulëta, nuk ka akademi honorifike, të gjitha janë me institute, domethënë, të gjitha merren me kërkimin shkencor dhe jo udhëheqin,

këshillohen, bëjnë kërkim shkencor, pa u marrë praktikisht me të. Kjo është dilema e madhe. Këtu keni edhe disa sugjerime.

Unë mendoj se Partia Socialiste, maxhoranca socialiste, e cila e kundërshtoi fort reformën shkatërruese të vitit 2007, e çoi edhe në Gjykatën Kushtetuese, duhet të gjejë forca për të bërë një reformim real të shkencës, të kërkimit shkencor, të rrjetit të kërkimit shkencor, në këtë kuadër, edhe të Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë.

Sot kemi dy akademi publike: Akademia e Shkencave të Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave të Albanologjisë, ndërkohë që minimumi, Akademia jonë e Shkencave ka qenë Qendra Botërore e Studimeve Albanologjike. Pse duhet që ligji të ndalojë ose të mos krijojë ligjërisht mundësinë që në Akademi të krijohen institute ose të bashkohen, nëse bien dakord, dy akademitë në një të vetme për të krijuar një model më të qenësishëm?!

Sidoqoftë, nuk po i lexoj të gjitha, sepse koha është e kufizuar.

Mendoj se ky projektligj nuk ka afërsi, madje as me modelin më të afërt, siç është Kosova. Flasim për integrim, qasjen tonë ndaj Kosovës, që gjithsesi duhet të jetë një qasje integruese. Ligji i ri i Akademisë së Shkencave të Kosovës, i miratuar më 14 dhjetor të 2015 është krejtësisht i ndryshëm në thelb dhe në parim me ligjin që pretendojmë të miratojmë sot. Është normale kjo?

Sidoqoftë, unë po ju them atë që kam studiuar dhe që mendoj se është shumë e rëndësishme: kam studiuar përvojën e të gjitha akademive të shkencave, edhe të vendeve të Bashkimit Europian, dhe nuk është thjesht fjala për vendet e Lindjes europiane, kam ndenjur dy javë në akademinë e Tajvanit, e cila nuk ka asnjë lidhje me komunizmin, se është themeluar në vitin 1929, ka 60 institute kërkimore dhe një sipërfaqe sa një lagje e Tiranës, pra nuk ka lidhje fare me ne. Ose akademitë e Shkencës së Holandës, Belgjikës, Suedisë, Greqisë, Polonisë, Çekisë, Sllovenisë, Hungarisë, Rumanisë, Bullgarisë, Kroacisë, të gjitha vendet e Ballkanit pa përjashtim. Nuk e kuptoj këtë ngutje! Edhe ligji i vjetër është pak a shumë e njëjta gjë. Skënder Gjinushin nuk e pengoi ligji i vjetër që të zgjidhej kryetar i Akademisë së Shkencave! Atëherë le të vazhdojmë me ligjin e vjetër, është kryetari i ri dhe ta kemi me ymër, unë nuk kam gjë personale me të, por, sidoqoftë të gjejmë kohën për t'u marrë me një reformë reale të Akademisë së Shkencave.

E fundit, është krijuar një kakofoni dhe unë nuk e di se çfarë po ndodh me kërkimin shkencor, sepse ka ligje që kundërshtojnë njëri-tjetrin. Është ligji për Akademinë, ka ligje që menaxhohen në akademinë tjetër, është një ligj i arsimit të lartë dhe i kërkimit shkencor në institucionet e arsimit të lartë. Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka sjellë një draftligj dhe kërkon

mendime për një ligj të integruar të shkencës, ku të përfshihen të gjitha. Unë personalisht kam biseduar me ministren e Arsimit, zëvendësministrin dhe rektorët dhe u thashë: “Ju lutem shumë, mos e fusni në rendin e ditës ligjin për Akademinë e Shkencave pa u bërë ligji i integruar për shkencën”, dhe më thanë: “Po, është shumë e vërtetë! Nuk kemi për ta çuar në parlament”. Të bëhet një herë një ligj kuadër për shkencën, pak a shumë sipas modelit të vitit 1984, dhe pastaj të flasim edhe për Akademinë e Shkencave, që është pjesë. Pra, të flasim për të tërën e pastaj t’i kthehemi pjesës.

Në vitin 2007 botova një artikull për një Akademi të re të Shkencave me idenë që, edhe po të mos e kishim, duhet ta krijojmë dhe derisa e kemi, duhet ta reformojmë. Mbjaj mend që në atë kohë Akademia e Shkencave e ka printuar atë material dhe ua ka dhënë 140 deputetëve, para se të futeshin në Kuvend, pra atë ligj, sepse ishte një ligj i argumentuar, bazuar në modelet europiane, amerikane, në modelin global, si bëhet kërkimi shkencor në këto vende. Vetëm Instituti *Max Plan* ka 100 institute kërkimore, pra është një rrjet institutesh kërkimore, le të mos u referohemi shoqatave.

Ju falënderoj, por ju kërkoj edhe ndjesë, se ndoshta duhet edhe një mendim ndryshe, duke menduar që edhe opozita nuk e di ku është, ky është mendimi im, e kam të argumentuar dhe, nëse ka profesionistë, jam i gatshëm për ta diskutuar. Ne kemi diskutuar edhe atje, madje kërkuam të vinin zoti Gjinushi dhe zoti Fuga dhe të na thoshin se çfarë po ndodhte me dy draftet që kishim, por nuk erdhën.

Ligji është diskutuar shumë formalisht në institucionet publike të arsimit të lartë. Një ditë i thashë zotit Gjinushi: “Zoti Gjinushi, keni bërë takime me institucionet publike dhe nuk na keni ftuar asnjëherë”. Mendoj se gjërat serioze duan seriozitet dhe nëse nuk mendojmë seriozisht për shkencën dhe kërkimin shkencor, nuk do të ketë zhvillim të qëndrueshëm në Republikën e Shqipërisë.

Besoj se fytyra do të rikthehet te shkenca dhe te kërkimi, që edhe Shqipëria të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme dhe jo sipas vullneteve të ditës, sidomos në kohën e temperaturave të larta qoftë politike, qoftë atmosferike.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, profesor!

I gjithë profesorati i thirrur, lutem të paraqisni të gjitha amendimet, propozimet tuaja lidhur me projektligjin, qoftë edhe mendimet ndryshe.

Opozita është e pranishme, unë jam kryetare e komisionit dhe përfaqësoj opozitën, kemi edhe anëtarët e tjerë të opozitës këtu. Ju lutem, të gjitha amendimet tuaja t’i paraqisni në sekretarinë e komisionit tonë, për të pasur kështu një draftim më të mirë të projektligjit.

Faleminderit!

Fjala për zëvendësrektorin e Universitetit “Ismael Qemali”, Vlorë, zotin Sokol Banaj.

Sokol Banaj – Faleminderit që na bëtë pjesë të këtij diskutimi!

Jemi koshientë që ndryshimet qoftë në ligjin e arsimit të lartë, qoftë në ligjin për Akademinë e Shkencave janë diskutuar dhe janë marrë mendime edhe nga IAL-të publike.

Duke parë projektligjin, dua të theksoj tri pika: në radhë të parë, është një projektligj që i cakton ose njeh detyrën e vetëriformimit të Akademisë pasur nevojën e komisioneve parlamentare, pra, e shikoj si një risi dhe përmirësim të ligjit të mëparshëm.

Së dyti, projekti e kthen Akademinë në një institucion të hapur, i cili mund të ripërtërihet nëpërmjet konkurrencës, gjë që nuk e kemi parë mbas vitit 2008. Pra, Akademia e Shkencës ka qenë si një “bunker”, ishte e vështirë të hyje brenda këtij institucioni. Ky projektligj u jep mundësinë të gjithë të interesuarve që të kërkojnë të hyjnë brenda institucionit, nëpërmjet konkurrimit dhe me anë të zhvillimit të kërkimit shkencor.

Jam dakord me parafolësit, për të parë në projektligj hapjen e instituteve kërkimore brenda Akademisë, pra të dëgjohet edhe zëri i profesorëve.

Pika e tretë është: kemi një ndarje të qartë në këtë projektligj për sa i përket anës kërkimore dhe administrative, gjë e cila lehtëson punën e Akademisë së Shkencave. Këtë gjë nuk e shohim në ligjin aktual në fuqi. Pra, ky projektligj është përmirësim i ligjit aktual. Për mendimin tim, ndoshta ka nevojë të rishikohen vetëm institutet.

Nuk do të zgjatem, sepse argumentet u rrahën edhe nga profesorët para meje. Ne, si përfaqësues të Universitetit “Ismael Qemali”, kemi 10 pika, të cilat do t’jua dërgojmë me shkrim këtij komisioni të nderuar.

Ju falënderoj që na bëtë pjesë të këtij diskutimi dhe ju uroj ditë të mbarë!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, profesor!

Meqenëse kemi të pranishëm në komision zëvendësministrin e Arsimit, zotin Redi Shtino, dhe grupin e iniciatorëve, jeni të lirë të bëni ndonjë pyetje specifike për sa i përket projektligjit.

Cili nga profesorët dëshiron ta marrë fjalën?

Skënder Topi - Faleminderit!

Ne i dhamë sugjerimet tona, do t'i sjellim edhe me shkrim, por shpresojmë shumë, sepse nuk është hera e parë që vijmë në këtë komision, që sugjerimet tona të reflektohen dhe të mos mbeten në letër.

Profesori i nderuar foli gjatë, bëri dhe politikë, edhe pse nuk jemi pjesë e saj, se atë e bëni ju, duhet respektuar secili nga ne për mendimin dhe sugjerimet që jep, por insistoј që të paktën sugjerimet që dhamë për dy a tri pika të rëndësishme të reflektohen, sepse përndryshe do të kemi një ngarkesë të madhe në IAL-të publike. Në qoftë se në projektligj do të mbetet monitorimi i kërkimit shkencor, përfaqësimi i anëtarëve të Asamblesë së Akademisë së Shkencave në senatet akademike, kjo do të thotë se nuk flasim më për autonomi, kështu që Akademia e Shkencave të bëjë punën e saj, të na ketë suport dhe të bashkëpunojë me ne. Pra, të gjenden hapësira në projektligj që të ketë mundësi për marrëveshje ndërinstitucionale, sepse ne jemi materia primare që prodhojmë akademikë të rinj apo të vjetër e kështu me radhë.

Siç e thanë edhe kolegët, unë ndoshta jam i fundit, pasi kam vetëm 10 vjet që ndodhem në Shqipëri, por nuk kuptoj asgjë nga Akademia e Shkencave. U bënë vite që e diskutojmë e me radhë, kështu që duhet ta shohim si prioritet këtë iniciativë, të mos jemi skeptikë, sepse ka vend për rregullime, për të cilat insistoј të bëhen.

Kemi diskutuar dhe debatuar gjatë edhe me deputetin e nderuar zotin Fidel për ligjin “Për sportin” dhe përfundimi ishte ndryshe. Me fuqinë e kartonëve nuk u ndryshua asgjë, me gjithë insistimin tonë, të rektorëve, të stafeve akademike, të departamenteve të sportit, që sporti është prioritet edhe i qeverisë, kështu që sugjeroј dhe jam besimplotë që sugjerimet tona do të merren parasysh.

Fatjona Dhimitri – Ju falënderoj, profesor!

Po, urdhëroni!

Adem Bekteshi – Në ligj duhet të futet fryma e bashkëpunimit. Ligji ka rolin drejtues të Akademisë ndaj institucioneve të arsimit të lartë. Ndaj ju, që do ta diskutoni, duhet të keni parasysh që të futet fryma e bashkëpunimit. Nuk mund të quhet hapje e Akademisë duke futur duart tek autonomia e institucioneve të arsimit të lartë, në kuptimin figurativ po ua them. Këtë nuk e quaj hapje, përkundrazi, e quaj zotërim të një fushe kundërshtare për të. Këtu nuk flasim për kundërshtarë realë, por për faktin e kërkimit shkencor. Ndaj, do t'ju sugjeroja ta shikoni me këtë frymë që institucionet e arsimit të lartë të jenë të barabartë me Akademinë në fushën e kërkimit,

sepse ne e thamë, jemi ne që i prodhojmë akademikët dhe me këtë sy duhet ta shohë edhe ligji strukturën e institucioneve të arsimit të lartë.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Ju falënderoj, profesor!

Dëshiron ndokush nga anëtarët e komisionit të ndajë diçka me grupin e rektorëve, zëvendësrektorëve apo me grupin iniciator?

Po, urdhëroni, zoti Fidel!

Fidel Ylli – Ju falënderoj për mendimet që dhatë!

Do të doja t'ju bëja me dije se ky projektligj nuk është votuar ende. Ne e kemi marrë shumë seriozisht si komision dhe si maxhorancë që Akademia e Shkencave të jetë në nivelin e akademive europiane. Ne nuk mund të mohojmë Akademinë e Shkencave të Gjermanisë dhe të Austrisë, nga ku janë marrë mendime dhe nga ku, bashkë me deputetët nismëtarë për ndryshimin rrënjësor të Akademisë së Shkencave, kanë ardhur ekspertë në këtë komision.

Dua t'ju them se, ashtu siç me të drejtë bëtë vërejtje për ato pika, duhet të na sillni në komision sa më shpejt edhe mendime me shkrim për mënyrën e bashkëpunimit me Akademinë e Shkencave. Nëse dje do të dëgjoni me vëmendje akademikët, por edhe sekretarin e Akademisë, zotin Tole, ai dha shpjegime, që për mendimin tim ishin tolerante, por duke parë edhe vërejtjet që mund të bëjnë rektorët, ne të bëjmë një ligj, i cili të mos jetë i kontestuar nga shumica e rektorëve të universiteteve. Debate do të ketë, zëra ndryshe është mirë të ketë dhe ka pasur.

Pas jush ne do të thërrasim edhe zotin Fuga, i cili ka qenë një zë ndryshe. Pavarësisht se unë mendoja që ai duhet të vinte bashkë me akademikët e tjerë, për të treguar tolerancën tonë, ne i kemi bërë një privilegj, që, ndryshe nga akademikët e tjerë dhe Asambleja, të cilët kanë qenë unanim për sa i përket këtij projektligji, ta thërrasim për të marrë edhe mendimin e tij.

Kështu që, unë ju lutem të na sillni sa më shpejt mendimet për bashkëpunimin me Akademinë e Shkencave, duke ruajtur edhe ligjin e arsimit të lartë, me qëllim që të bëjmë një ligj të mirë për Akademinë e Shkencave që, për mendimin tim, është një institucion shumë i rëndësishëm, pavarësisht se ka qenë shumë i vakët në këto vite.

Shpeshherë kanë kërkuar lëmoshë në komision, por unë kam ngritur zërin duke thënë që Akademia e Shkencave është institucion elitar për sa i përket kombit shqiptar, të gjitha institucioneve kërkimore shkencore.

Së pari, duhet të fillojë nga godina.

Po të shikoni godinën e Akademisë së Shkencave të Kosovës, është njësoj si godina e Ministrisë së Arsimit, kurse ne e kemi akoma me qera.

Ne nuk duhet ta injorojmë Akademinë, por duhet të ketë një bashkëpunim frytdhënës ndërmjet senateve të universiteteve dhe Akademisë së Shkencave dhe gjithë akademikëve që mendojnë se duhet gjetur forma e bashkëpunimit. Është nder për një senat që të ketë një akademik pjesë të senatit të një universiteti, qoftë të Shkodrës, qoftë të Elbasanit apo qoftë të Tiranës.

Që të mos kemi përplasje ligjore, ju mundohuni të shikoni mënyrën se si do të jetë ky bashkëpunim.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Beqiraj!

Ismet Beqiraj – Përshëndetje kolegë, zëvendësrektorë dhe rektorë!

Ju falenderojmë për mendimet dhe shqetësimet që keni!

Unë do të përdor një shprehje popullore: “Më mirë të kesh një palë pantallona të gjata dhe i shkurtton sesa të kesh të shkurtëra dhe nuk i zgjat dot”.

Në këtë fazë përmbyllëse të sesionit parlamentar ne kemi për diskutim projektligjin “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, që ka shumë kohë që nuk merr oksigjenin e nevojshëm në tregun e kërkimit shkencor dhe të botës akademike. Me të drejtë do të ndalem te sugjerimet dhe kontestimi që i bëri këtij projektligji, jo thjesht për ta kundërshtuar, kolegu i Universitetit të Durrësit, i cili tha se ky projektligj nuk reflekton asgjë nga ligji aktual.

Sinqerisht, edhe unë kur shikoj ligjet e viteve 2004 dhe 2007 dhe një ndryshim të vitit 2010, mendoj se ky projektligj është si nata me ditën me ligjet që kanë funksionuar për 15 vjet në Akademinë e Shkencave, deri aty sa e futën në kolaps për zgjedhjen e drejtuesve, për pranimet e reja e të tjera.

Ju evidentuat risitë që sjell ky projektligj dhe ngritët shqetësimet tuaja. Kolegët tanë, që janë në universitete, akademikë ose akademikë të asociuar, kanë pasur një shqetësim për vlerësimin e këtij titulli akademik shkencor, për t’u përfshirë apo për të marrë pjesë në senate pa të drejtë vote.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, ta mbaroj mendimin!

Fajtona Dhimitri – Profesor, urdhëroni!

Po flasim për një draftim të mirë të projektligjit. Nëse profesori dëshiron të thotë diçka ...

Ismet Beqiraj – Ju lutem, ta mbaroj!

Jam plotësisht dakord për vendosjen e balancave reale, që kërkon ju, midis drejtuesve të institucionit të arsimit të lartë, që të jenë pjesë në asamble, dhe akademikëve, që të jenë pjesë në senat, edhe pa të drejtë vote, sepse është kontribut dhe respektim për atë që ata përfaqësojnë në botën akademike shqiptare.

Më e rëndësishmja, që nuk është në asnjë draft, është që ne me këtë projektligj kemi përmirësuar dhe kemi rritur nivelin e statusit juridik të këtij institucioni shkencor. Po të shikoni, sinqerisht nuk e kuptoni çfarë është, sepse duket sikur është një organizatë jofitimprurëse, joqeveritare, pra, hajt se duhet një Akademi Shkencash.

Nga ana tjetër, në nenin 3 thuhet: “Akademia është institucion publik dhe autonom në fushën e kërkimit”. Shqetësimi që unë kam si deputet dhe si pjesë e botës akademike është që këto ligje i shkatërrojnë, i shkrinë institutet e kërkimit shkencor në Shqipëri. Në këtë projektligj, në konceptin që jemi konsultuar, te përbërja e Akademisë përfshihen edhe disa struktura të ngritura në përbërje ose pranë saj, si: seksione ose komisione dhe njësi kërkim-studimi. Akademia e Shkencave është ombrellë e këtij rrjeti të instituteve të kërkimit shkencor. Këto janë parashikuar edhe te ngritja dhe funksionimi i këtyre instituteve, ku thuhet: “në përbërje dhe pranë kësaj akademie”. Unë nuk e kuptoj. Ne kemi dëgjuar që e gjithë bota akademike, e gjithë media, janë pyetur duke parë procedurat nga ka kaluar rruga e këtij draftimi, deri në depozitim në komisionin tone parlamentar. Mendoj se është i plotë. Madje, ky bashkëbisedim dhe kjo dëgjese i shërben kësaj çështjeje.

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, zoti Beqiraj!

Urdhëroni, profesor!

Lek Sokoli – Duhet të shprehet shumë qartë: “Akademia e Shkencave është institucioni më i lartë i kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë”. Kështu ka qenë para vitit 2007, por nuk është në asnjë nga draftet ose në ligjet e mëvonshme. Të mos merremi me fjalë, sepse është institucioni publik më i lartë që përfaqëson dhe bart vlerat. Vlerat janë relative. Kush tha që mbart vlerat më të larta Akademia e Shkencave?

E dyta, duhet të thuhet qartësisht: “Akademia ka për detyrë të kryejë kërkime shkencore fundamentale dhe aplikative në fusha të ndryshme të shkencës, sidomos të shkencave albanologjike”.

E fundit, kemi një përvojë shumë afër, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e cila e aplikoi ndryshimin e statusit të akademisë nga akademi kërkimore në akademi honorifike dhe shumë shpejt e korrigjoi, sepse janë 500 institute, sidomos ato që lidhen me identitetin kombëtar. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës e dinë shumë mirë dhe duhet t’i bashkëngjiten Akademisë, pak a shumë, me një status, siç e ka Kosova, që të trajtohet ndryshe dhe në të njëjtën kohë të përfaqësojë shkencëtarët edhe në nivel kombëtar, në të gjitha fushat e shkencës.

Shikoni modelin e spitaleve. Themi “Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”” sepse është e njëjta me Universitetin e Mjekësisë, ose “Spitali Universitar i Traumës”. Në këtë mënyrë, me universitetet publike bashkë me Akademinë e Shkencave, mund të krijohen qendra që të financohen drejtpërdrejt dhe jo t’i lihen universitetit. Instituti i Fizikës Bërthamore iu la Universitetit të Tiranës dhe shkoi në zero. Nuk duhet t’u lihen universiteteve, por të financohen. Kjo është përvoja e Portugalisë, ku thuhet qartë se kërkimi shkencor në Portugali bëhet nëpërmjet qendrave në 14 institucione publike të arsimit të lartë, që financohen drejtpërdrejt. Ka shumë modele dhe të mos themi se kemi marrë mendime. Pse duhet të marrësh mendimin e një austriaku dhe të mos marrësh modelin e Akademisë së Shkencave të Austrisë? E gjithë bota ka marrë mendimin e Akademisë së Shkencave të Austrisë, ndërsa ne marrim mendimin e një eksperti austriak ose gjerman.

Unë nuk bëj politikë. Kam qenë anëtar i Komisionit të Arsimit dhe Shkencës në zgjedhjet e vitit 2013, ku kam dhënë një kontribut në Partinë Socialiste, kur ishte zonja Shamku. I kam ndjekur këto gjëra, nuk kam qenë jashtë loje dhe nuk bëj politikë, por për aq kohë sa po diskutojmë të hedhim themelet, të mos vazhdojmë të zhytemi në një errësirë, nga e cila nuk do të ketë Zot të na nxjerrë, por të bëjmë një ndryshim real. Pra, të kemi guxim të ngrihemi. Akademikët nuk cenohen. Askush nuk po e ndryshon statusin e akademikëve.

Po ashtu, mendoj se nuk ka arsye ta kufizojmë moshën 75 vjeç, sepse 2 herë në vit shkohet në mbledhjen e Akademisë së Shkencave. Për shembull, Kadareja është anëtar i Akademisë së Shkencave të Francës dhe nuk është anëtar i Akademisë së Shkencave në Shqipëri, sepse është mbi 75 vjeç. Kjo nuk ka logjikë. Përdje në Amerikë u martua një çift, 101 dhe 103 vjeç. Jetëgjatësia

është rritur, ndërsa ne vazhdojmë të kufizojmë moshën. Megjithatë, këto janë detaje që nuk më interesojnë shumë.

Në thelb, Akademia e Shkencave do të jetë institucion kërkimor, që do të merret me kërkimin shkencor apo do të vazhdojmë me parimin: ti zot, unë zot, gomarini kush e kullot? Kush do të merret me kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë? Kjo është çështja. Shqipëria, me këtë potencial që ka, nuk ka këllqe. Është luks i tepruar të krijojë një akademi honorifike me 40 anëtarë, disa prej të cilëve nuk jetojnë fare në Shqipëri. Ai ka vite që jeton në Francë dhe merr rrogën si akademik. Tjetri ka gjithë jetën që është profesionist i një sektori tjetër, por vazhdon profesionin e shkencës dhe merr rrogën. Këto gjëra nuk shkojnë. Nëse doni të bëjmë diçka, sa për t'i thënë opinionit publik që u ndryshua edhe kjo, unë nuk jam dakord!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit!

Po, urdhëroni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Profesor Leka, kam marrë fjalën për procedurë.

Ne kemi bërë dëgjese me elektoratin për të folur në përgjithësi për ligjin, por edhe që ju të depozitoni pranë nesh qëndrimet që keni për çdo nen.

Dua të theksoj se kjo punë është serioze, nuk po e bëjmë thjesht se e kemi për detyrë. Fakti që ju kemi thirrur tregon se kemi shumë ndjeshmëri për mënyrën se si i gjykoni ju kërkimet shkencore pranë universiteteve dhe qasjen që keni në përgjithësi për kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë. Përveç qëndrimeve të përgjithshme, që i dëgjuam, ne kemi nevojë të na i jepni të depozituara qëndrimet tuaja që t'i kemi gjatë diskutimit nen për nen, sepse kjo është arsyeja pse ka ardhur projektligji që është depozituar si nismë nga një numër deputetësh të Kuvendit.

Ju lutem, ne e kemi *brewing storm*-in tonë këtu Brenda, për të kuptuar se cila do të jetë qasja në kërkimin shkencor. Unë do t'ju lutesha që ne të konsumojmë kohë të dobishme, duke ndihmuar njëri-tjetrin për të përmirësuar ligjin.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit!

Keni diçka tjetër për të thënë? Ka ndonjë mendim tjetër nga profesori, rektorët apo zëvendësrektorët?

Urdhëroni, zonja Kodheli!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Për sqarim, unë nuk jam këtu si anëtare e këtij komisioni, por si një nga anëtarët e grupit të deputetëve nismëtarë të këtij projektligji.

Ju dëgjova me shumë vëmendje, profesorë të nderuar.

Shpresoj të jem shteruese dhe të flas shkurt.

Ju, ndoshta, me të drejtë tentoni të thoni gjithmonë se jeni njerëz apolitikë, që nuk merreni me politikë dhe se këtu keni ardhur për të tjera gjëra. Me gjithë respektin për opinionin që keni për veten, unë besoj se të gjithë ne këtu jemi njerëz politikë, sepse politika është instrumenti që mundëson punën tuaj, tonën dhe punën tonë të përbashkët. Asnjë gjë nuk është jashtë politikës. Edhe këto që ju bëni, të gjitha janë pjesë e politikës, se duhen gjetur instrumentet, duke filluar që nga ligji, deri te mënyrat e zbatimit të tij në praktikë, të ngritjes së reputacionit të një institucioni, dikur me një reputacion të caktuar, që sot nuk është atje ku duhet, kuptoj unë, ndaj edhe përmirësohen dhe amendohen ligjet. Sigurisht që kur ka një diskutim politik, ka edhe një diskutim teknik, që i qaset diskutimit politik dhe na sjell ne në pika të përbashkëta. Komenti im është shumë i shkurtër. Me shumë dëshirë dhe me shumë respekt pres çdo koment tuajin, realisht.

Dëgjova profesor Lekën, i cili, midis shembujve të tjerë, tha: “Serbia dhe Maqedonia po e fuqizojnë akademinë”. Në gjykimin tim, ka arsye politike pse fuqizohet akademia. Korea e Jugut përdor 6% të GDP-së. Ka arsye politike dhe ekonomike pse Korea e Jugut përdor 6% të GDP-së për *Infusion Developer*. Pra, arsyet pse Shqipëria duhet ta fuqizojë kërkimin shkencor, pse duhet të fuqizojë kërkimin në Albanologji, dhe jo vetëm, duhet të jenë më së pari politike.

Patjetër që ka edhe arsye ekonomike, po të doni edhe personale, sepse sigurisht, ne dhe ju kemi mbërritur deri këtu me sedrën që na ka shoqëruar dhe na e ka mundësuar këtë gjë, përtej kushteve ku e kemi zhvilluar këtë sedër.

Thënë kjo, mendoj se ne duhet të bëjmë një diskutim që del edhe mbi ju, si përfaqësuesit më të lartë të institucioneve që përfaqësoni, që del përtej interesave të strukturave që drejtoni apo mbi ne, për atë me të cilën merremi. Të bëjmë një diskutim mbarëkombëtar. Ndoshta fjala është shumë e madhe për të shkuar paralel me diskutimin teknik, por si do të veprohet nëpërmjet ligjit dhe akteve nënligjore për ta bërë ligjin të zbatueshëm. Ligjet nuk janë të këqija, nuk kanë qenë asnjëherë të këqija, por zbatimi i tyre është i gabuar, tendencialisht i gabuar, në disa raste, apo nga padija, në disa raste të tjera. Duhet të mundësojmë ngritjen në nivelin që Akademia meriton, që e meriton puna juaj drejtuese dhe shkencore, dhe që në fund të ditës e meriton edhe Shqipëria,

e cila përparon edhe për shkaqe politike të mirëfillta, e ritheksoj, dhe sigurisht edhe për shkaqe ekonomike.

Unë e mbështes atë që tha kolegja Ekonomi për paraqitjen nga ana juaj të të gjitha ankimeve, amendimeve dhe opinioneve që keni për nenet e këtij projektligji dhe mbërritjen në një emërues të përbashkët, i cili do të kënaqte arsyet politike, teknike të mbarëvajtjes së të gjithëve ne, sepse jemi këtu për një qëllim të përbashkët, që i tejkalon interesat e vogla, jo personale, të mirëkuptohemi, të jeni pro strukturave që ju drejtoni dhe që ne jemi të nderuar që ju t'i përfaqësoni këtu. Ky ishte komenti im.

Faleminderit, zonja kryetare!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit!

Urdhëroni, profesor!

Skënder Topi – Faleminderit, zonja kryetare!

Ju dëgjova me shumë vëmendje dhe me shumë respekt, zonja deputete. Ne që jemi në universitet, vërtet bëjmë politikë, por bëjmë politikën e universitetit në interes të stafëve akademike dhe të studentëve, jo politikën e PS-së, të PD-së apo të ndonjë partie tjetër.

Domethënë, kam qenë shumë i drejtpërdrejtë gjatë gjithë aktivitetit tim në Shqipëri.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Ju lutem, zonja Kodheli, ta lëmë profesorin të flasë.

Skënder Topi – E dyta, unë lexova ato që janë të shkruara, por ka edhe shumë gjëra të tjera që thanë kolegët. Dua t'i them zonjës deputete se realizimi i këtij projektligji, përbërja e tij kështu siç është, do të thotë se nëse nuk ndryshohen 2-3 pika, që janë minimumi i domosdoshëm, ne do të biem në varësinë e burokratëve dhe të krijimit të instancave, siç është Akademia e Shkencave, që duam ta rregullojmë. Ne jemi në Shqipëri, edhe nëse nuk jetojmë këtu. Është domosdoshmëri që të gjitha pikat që thamë të reflektohen.

Ju thatë se duhet t'i sjellim me shkrim. Me shumë të drejtë, duhet t'i sjellim me shkrim, por i them këtij komisioni, me shumë përgjegjësi, pas një eksperience 20-vjeçare në Perëndim, që letrat ngelen, ligjet ngelen dhe ne vuajmë. Ky është një problem shumë i madh, që duhet reflektuar për të mirën e të gjithëve.

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, profesor!

Ka ndonjë mendim tjetër nga profesorët?

Të nderuar profesorë, unë kam një pyetje: a ka pasur diskutime për projektligjin e Akademisë së Shkencave, meqenëse kemi të pranishëm zotin zëvendësministër? Kjo është e vetmja platformë që është diskutuar me ju? A ka pasur një platformë tjetër alternative? A mendoni se kjo ka qenë platforma më e mirë?

Urdhëroni, zoti Shtino!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Komisionin këtu e drejtoj unë.

Ju dëgjova ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pyetjet po i bëj unë tani.

Ju lutem, zoti Shtino dhe më pas profesorët.

Do të flasë zoti Shtino dhe më pas grupi i rektorëve.

Milva Ekonomi – Tha për procedurë.

Ju drejtoni komisionin, por vendimet e komisionit merren me shumicë votash.

Fatjona Dhimitri – Zonja nënkryetare, unë ju dëgjova.

Tani kam edhe unë diçka për t'iu drejtuar profesorëve dhe zotit Shtino.

Zoti Shtino, urdhëroni!

Redi Shtino – Atëherë, për të mos u bërë pjesë e diskutimit të këtij komisioni, meqë nuk i përkas strukturës së komisionit, ju keni thirrur më pas akademikun Fuga, i cili besoj se do ta shterojë gjerësisht alternativën e platformës së tij.

Për çështje procedure, ne kemi kërkuar nga IAL-të një vlerësim të të dyja platformave, që na kanë ardhur në formë të shkruar. Ju dje e kërkuat specifikisht dhe jua kemi nisur me shkresë sot. Mund të kërkontë në protokollin tuaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka ardhur në komision?

Dakord.

Fatjona Dhimitri – Profesor, urdhëroni!

Lek Sokoli – Ministria na ka dërguar dy draftë: draftin e Fugës dhe draftin e Gjinushit.

Fatjona Dhimitri – Çfarë mendoni për draftet?

Adem Bekteshi – Ne e kemi dhënë mendimin tonë me shkrim, edhe pasi i kemi diskutuar në institucionet akademike të universitetit. Gjithashtu, kemi bërë edhe ballafaqim me një grup ndërministror të kryesuar nga Ministria e Arsimit, që ka ardhur atje. Ne mendojmë se në thelb nuk ka ndryshime të mëdha; drafti i Fugës dhe drafti i Gjinushit nuk kanë ndryshime parimore. Të dy janë të mendimit që të kemi një akademi honorifike, një akademi që nuk do të merret me kërkimin shkencor dhe, meqenëse nuk merret me kërkim shkencor drejtpërdrejt, do të kërkojë punë, do të kërkojë të mbulojë, pak a shumë, kompetencat që ka pasur dikur Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë, që nuk është më, të monitorojë universitetet, të bëhet tutelë e universiteteve e të tjera, gjë që nuk është e drejtë.

Unë nuk do të jem në komisionin për draftin e Fugës. Artanin e kam mik të vjetër, të paktën prej 35 vjetësh, dhe kam shumë respekt, por për mendimin tim ka bërë një material të dobët, që nuk vlen të diskutohet, sepse është më i dobët se ky që kemi këtu. Unë nuk e di se në çfarë gjendjeje ka qenë Artani kur e ka dërguar. Nuk mund të thuash “100 akademikë”. Ne nuk po i mbajmë dot kaq sa janë.

Në thelb, drafti i Fugës me draftin e Gjinushit janë e njëjta gjë: Akademi honorifike, që nuk merret me kërkimin shkencor. Përderisa nuk merret me kërkimin shkencor, çfarë do të bëjë? Do të këshillojë. Si do të këshillojë? Shkencëtarët këshillojnë nëpërmjet studimeve të tyre, ata nuk janë këshilltarë. Këshilltarët janë tjetër gjë dhe ju e dini më mirë se ne. Do të koordinojë? Si do të koordinojë? Ne kemi dhënë një skemë reale se si mund të bëhet më mirë kjo gjë.

Fatjona Dhimitri – Dikush tjetër nga profesorët?

Po, urdhëroni!

Lek Sokoli – I takoi të fliste më shumë Skënderit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E njëjta gjë është. Te ne kanë ardhur të dy draftet, madje shumë kohë më parë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka shkuar në të gjitha universitetet. Në pikat e kontaktit të ministrisë jemi të gjithë rektorët dhe drejtorët e instituteve kërkimore. Draftet na kanë ardhur dhe janë diskutuar. Siç e tha edhe kolegu para meje, thelbi është i njëjtë, veçse ndryshojnë disa modalitete.

Diskutimet janë bërë, por stafet akademike nuk e kanë të qartë, sepse edhe në ligj nuk është shumë e qartë. Mund, mund, mund. “Mund”, do të thotë ose ndodh, ose nuk ndodh. Duhet të paraqitet qartë. Ligji duhet të jetë i qartë. Do të ketë institute që janë të ndryshme nga njësitë ...

Njësitë çojnë në departamente, kurse departamentet në institute. Kur flasim për institute, minimalisht duhet të jenë 21 persona kërkues, sepse kështu e ka ligji i arsimit të lartë. Nuk mund të ketë ligj tjetër për institutet në Akademi. Pra, në ligj duhet ta shprehim qartë mendimin dhe jo “mund të organizohet” apo “mund të ketë”.

Akademiku vlerësohet si kreu i shkencës shqiptare në një fushë të caktuar, që ka shkuar aty në bazë të një pune kërkimore shkencore reale, të vlerësuar jo vetëm brenda vendit, por edhe jashtë. Duke qenë kështu, ky rol duhet t’i jepet. Mendimi im personal, por edhe i shumë kolegëve të mi, me të cilët e kemi diskutuar, është që t’i jepet roli që i takon. Akademiku është titullari më i lartë në një shkencë të caktuar dhe ne duhet të luftojmë që kështu të jenë akademikët tanë.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit!

Fidel Ylli – Dua të them diçka për sa i përket një sugjerimi apo vërejtjeje që bëri zëvendësrektori i Universitetit të Durrësit, i cili tha që si do t’ia bëjmë me Ismail Kadarenë, i cili është mbi 75 vjeç.

Po ta lexoni ligjin me vëmendje, të gjithë personat që kanë titullin “Akademik” , do t’i kenë të gjitha të drejtat tyre edhe pas moshës 75 vjeç, pavarësisht se nuk do të jenë si bërthamë reale e numrit të caktuar të akademikëve, por kanë një status të veçantë “emeritus”. Do të thotë që do të jenë akademikë dhe kanë të gjitha të drejtat e tyre. Sa për informacion, Ismail Kadare ka votuar në zgjedhjet e fundit.

(Diskutime pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Të nderuar profesorë, ju falënderojmë për pjesëmarrjen tuaj në komision! Ju lutem, që mendimet tuaja t’i depozitoni pranë sekretarisë së komisionit! Nëse nuk keni diçka tjetër për të shtuar, ju falënderojmë për pjesëmarrjen!

Mbledhja mbyllet këtu.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

